

8SH-1

V27

# BLERIM NËNDORI

(POEMË)

JARFI

g

ANDRE

891983-1

✓ 27

ANDREA VARFI

5

# BLERIM NËNDORI

## (POEMË SIMFONIKE)

~~38370~~ 14495  
BIBLIOTEKA E SHTETIT  
SHKODRA

Redaktor: Halil Qendro  
Korektor letrar: Enver Fico  
Kopertina: Dolli Gjinali  
Redaktor teknik: Adem Lita

Tirazhi 2000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-65

---

Shtyp N.I.Sh. Shtypshkronjave «Mihal Duri» — Tiranë 1966

## P R E L U D

Me ballin lart,  
sy-ushtë e veshë-mprehtë,  
çaj terrin,  
natën,  
thërmoj retë,  
shtërgatat tret;  
dhe Kohës vetë,  
e Djellit-at e rreze-nxehtë,  
e Tokës-nënë gjire-jetë,  
u flas krenar  
si shqipëtar:  
— Për të rrëfyer ç'jemi  
e ç'qemë,  
ne bijt e lisit ilirik,  
s'kërkoj as sonda,  
as palombarë  
të xhvat thellsish ndonjë relik  
të kushdi  
ç'rodi më antik,  
(mbytur në ndryshk e leshterik).  
Dhe me trumbeta  
e me gërneta,  
e zurna  
e tambura,  
ta shpall

«të parin ndër të parë!»

S'më duhet as të mbreh kularë,  
edhe me qafë  
e gjuhë zvarrë,  
të shuhem brazdash,  
të hap tumba  
dhe t'i rëmoj kushdi kujt varrë;  
as të nxjerr kushdi  
seç tokzë  
apo tarokzë,  
si letër-të-njoftimit të Shqiprisë  
në lashtësitë e historisë së njerëzisë.

Ngado që unë të vërtitem:  
eterit lart  
si qift t'i ngjitem,  
n'humnerë e det  
thellë të zhytem,  
kudo,  
ngado  
që t'i shtrij sytë:  
në malet-flamuj t'Arbërisë,  
që s'njohën ndragën e poshtërsisë  
(edhe në kulm të varfërisë)  
më shkrepin gjerdanë yjesh,  
e ndrisin grykash,  
pyjesh,  
dhe varg po më rrëfehen,  
me bardë malësorësh,  
(e jo poetë oborrësh),  
edhe shkëmbënjk e gurë  
e ndënëdheu furrë,  
e qiell,  
yje,  
e detë,

me Mëmëdheun vetë...  
Ndaj shoh kudo të ravizuar,  
ndjej duke ushëtuar,  
mbi dallgët  
helm,  
gjak  
e maraz,  
si zulmë shekujsh brengë-e-gaz,  
varganit shkulmë-shkumbë t'hisorisë.  
një simfoni,  
kënduar shqiptarisht  
lirisë!

## KOHA E PARË

### Jehona legjendash

Të shoh  
o mëma jonë, djellorja Shqipëri:  
këtu stërlashtit;  
këtu sot:  
fëmi-kërthi,  
e vashë vetullhënë,  
nuse nerajdhë  
edhe amvisë amvone;  
blegtore bletë,  
bujke bujare e bujëtare;  
ndër sheshe e shtigje  
shigjetë ushtëtare.  
E punës,  
paqes,  
zemrës dhe lirisë,  
rojtare;  
përherë e larë, e lartë,  
e lashtë edhe e re!  
Nuk pate ti  
shumë herë as bukën  
me shëllirë,  
po dora nuk t'u nde,  
as si lysare,

a zuskë lapërdhjare,  
o bijë e vashë e motër,  
o nëna shqipëtare!  
Ja vale e hone e gryka,  
si gjithmonë,  
të moçmet muzgje murmurojnë:  
Veshët i ngreh,  
e nga Bregdeti,  
vështrim e krye hedh në kreshtë,  
në kreshtën e Korabit krismëtarë.  
E flladi i freskët  
në gjethe vgjeri e breshte,  
si dushqeve Dodonës e Tomorrit.  
më shushurin  
të thëna të stërlashta  
e legjendare:  
«Nuk është shëmbër e lëshuar,  
te kjo trevë, te ky truall,  
Shqipria,  
shqipja juaj,  
shqiptaria,  
më ngjan se shushurin sot shushurima  
sepse stërgjyshët tuaj  
këtu kërbaç s'i suall.  
Në janë vazhdë  
pellazgë,  
trakë,  
ilirë,  
këtu le të lëvrojnë lëvrimtarët.  
Për ne mjafton  
që bij lisash të lirë  
përherë malesh kemi qenë...  
dhe jetë e vdekje kemi dëshmitarë.

«Bardha, bareshë,  
një bijë e Dheut, Orë.

me Yllin, një bir Djellit,  
u ngjiz stërgjyshve tuaj jetë.  
«Të Mirët» qenë krushq  
dhe Gjigantët dasmorë  
dhe lajmëse shqiponja e qiellit,  
shqiponja shikim-mprehtë.  
Në pyjet, në djep degësh me fletë,  
e gjethë dushku,  
më ngjan se shushurin sot shushurima,  
e ëma, Orebardha,  
(helenët vonë e qojtën Galatea),  
Bardhyllin rriti.  
Ky shpejt na hodhi shtat,  
edhe përpjetë  
harboi si një lis me krahë e fletë.  
Si qomyrtar nuk pati shok në jetë.  
Prej tij buizën mbroth  
bisqe brez pas brezi,  
bujarë bujq  
dhe barinj suferinash.  
Kudo kërciste,  
tok me kërcim e këngë,  
i çiltër një çekan,  
çekani çikë e flakë i kudhrës,  
çekani i dlrë i punës.  
Ahere ende nuk ndjehej ankthi i dhunës:  
aroma e bukës,  
mbrujtur magjesh gjakut!  
O bisqe dhe biskaja t'arbërisë,  
prej tyre rriddhni ju,  
n'aradhe të përjetësisë.  
blerim edhe në shkrepëtima  
më ngjan se shushurin sot shushurina».

## Tabllo ilire

Në bjeshkë, brinja e brigje,  
djersitur nga lërimi,  
flладитур te burimi.  
ashtu si Orëbardha,  
billonjat nuse —  
nënëzat ilire,  
po mëndin foshnjëzat e tyre,  
Me ninulla të brishta  
ato u terin lotët;  
dhe foshnjëzat pas mëkimit,  
gumzhijnë posa bletë e plotë.  
... Dhe mbroth mbuluan  
luadhe, lugje  
e brigje detesh.  
Në brazda djerse  
jetesës amzën ja zbuluan!  
Me ç'parfum pishash,  
pjergullash,  
e prej ç'kullotash e luadhesh,  
nga tufa gjedhesh,  
dhënhsh lesh-kunadhesh,  
prej ç'rrëzë brigjesh e shullëresh,  
hej! ç'gjalpë e djathë,  
e ç'vaj e verë qehlibar,  
q'e ndezin syrin ziliqar,  
me çfarë anijesh kapedane:  
heshtat stërkala liburniane,  
nga skelat tonë.  
buzë-detesh,  
kudo  
qendisur. prej qytetesh,  
qytetesh tonë:  
iliriane,

ngado  
kanisket tona çojmë,  
këdo  
për vllamëri e flojmë!

### Shtërgatë

O anëdeti ilire,  
o brigje,  
brinja me buronja,  
si vashat  
veshur pér të vjelat;  
o pllaja ku krekohej  
për qëngjat trëndelina;  
verrishte,  
dasmë gjedhesh  
e l'hënh, dborë luadhesh;  
o ara,  
mbarsur nga të lashtat,  
pemishte,  
pemë-ngjeshur t'Ilirisë  
ullishte,  
o lumbardha t'Arbërisë:  
mbi ju u nis  
shtërgata,  
shtriga e zisë:  
me Kronusin,  
despot fëmijëmbytës,  
me Zojzin,  
zullumqarin zotëronjës,  
Merkurin,  
bark-lubinë luftënxitës.

me Martin,  
legjionar jetëshkretonjës,  
romakët kamës  
fort keq  
frotat ndërkriven,  
n'ushtarë  
e shigjetarë  
ato i kthyen,  
n'ordhi pa cipë, grabitqare,  
të mahej Roma rrënimqare,  
pa le të mbytej bota varre!

### Përmbytje

Ish natë e errët e njëj prillit  
e dritë kish çdo prak.  
Qetohej, i qetë iliri,  
e foshnja topolak  
nënën kërkon.  
Përralla gjyshja po tregon.  
Si mblodh nga çdo batak,  
e nga çdo shpellë e anë,  
ulkonja Romë,  
tinëzisht,  
përmbyti brigjet tanë!  
Në zjarr zhurit qytete!  
E flakëritën  
dallgë e dete.  
Nga flakët  
qjelli ynë i nxirë skuqte  
dhe nata vetë zbardhëllonte.

Të dukej djelli  
befas dilte:  
kjameti  
përmbi tokë çfrynte!  
çdo gjë zhuriste,  
shkrumbonte,  
shkretonte!  
Ndër ne  
ende  
nuk dinin çdo të thosh «lugat»!  
Ende  
nuk dinin se lugaten  
legjionare,  
as gjumi  
nuk e zinte dot rehat,  
veçse mbi shkretëtira  
e varre,  
ku bekon vdekjen  
«shpëtimtare»,  
dhe «paqe» e pagëzon:  
robërinë  
robër-pronjare!

### Divi ilir

E nxehtë vera, të zhurit.  
E mvrejtur vera, të drobit.  
E brigjet,  
brinja — ndënë pranga.  
Edhe robinjat  
ndënë kama  
të legjionarit llërëdanga

nga malet,  
vështrim-mekura, vështrojnë.  
Në prak të vdekjes  
sytë kurdo  
djellin kërkojnë!  
Por, hej!  
dhe robit sy  
të rodit tonë.  
si ushta zjarri e zjarrëtojnë  
ulkonjën,  
sypërbindshen Romë!  
«Pa bindur malet.  
nuk binden dot  
as brigjet. valet!»  
Gulçoi  
sypërbindshja n'ulërimë.  
Dhe mbyt,  
e përmbyt  
grykat  
me gulçimë  
legjonesh, pas legjionesh,  
shigjeta.  
flakë e vërcëllimë!  
Thua, çdo gjë  
po shuhet në një grimë!  
  
«Po ndal! Bre, ndal,  
o legjionar!  
S'të kosit kosa si në bar!  
Ti re në shkrep,  
andai prit shkrepëtimë!  
Pa shih!  
Pa shih!  
Mes flakësh çan  
kushtimi me fërtymë,  
me kuje dhe me kërcëllimë,

n'ilirë malit  
buçet bubullimë!  
Thonë ishte një nëndor,  
me shqotë, suferinë, me dëborë.  
Ngado,  
kudo  
nga shpellat del po i njëjti div:  
nga shkëmbi  
shtat e shpatull s'i dallohen,  
Balluket-plumb.  
Si det me dallgë  
e ka vështrimnë.  
Ngër grushtin lart  
dhe si tërmët  
buçet:  
«Ku jini djem të lirë!»  
E hone, e gryka u drodhën:  
«Ullalla! Ullalla!  
O burrat e të lirëve mbë'ta!  
Lëshohen brana  
e shumgullojnë shullënje  
harca, dragë, ortekë,  
jo dëboret,  
po shkëmbenjsh karpatë,  
ushtojnë ushtat  
helm e flakë.  
Dërmash dërmohen trupa e shpata.  
për legionarë ra mandata:  
përrenjve kërma  
i gjeti nata!

Ulkonjën, Romë  
e zuri data,  
na qënkej pisk malevet larta!

E pisk na qënkej gjithëmonë  
në malet shkëmb  
të shkabës sonë,  
që gjithë zogjtë e saj thërret.  
ndën një flamur, flamurë e vet!

## KOHA E DYTE

### Në prag të Nëndorit të Krujës

Tomorri, mali luan,  
i shenjtë e aqë i lashtë,  
m'i lashtë  
se krejt lashtëria.  
me kreshtën,  
krelë në kurorë purpri,  
me mjekrën,  
dëborë e të përzhitur,  
me kokën lart në re,  
sikur po mban të gjithë qiellin.  
me gjithë yjet,  
me hënën edhe diellin,  
hap sytë e sertë  
e bebzat rrotullon,  
hap veshët bron  
edhe përgjon,  
e ngryset kur ai dëgjon  
krahrorë e fushës që rënkon:

«Gjer kur robinja vallë këto anë?  
Gjer kur kafshata  
u kafshuaka me lot?  
Tomerr, me malet,

qysh duroni dot?  
Më thuaj vallë ti ç'mendon?»

Tomorri, mali luan,  
i shenjtë e aqë i lashtë,  
m'i lashtë  
se krejt lashtëria,  
hap gojën edhe turfullon:

«Fatthëna shtrigë po lëngon  
e flakur thellë në një hon,  
se mjaft gënjeu  
e vu në gjumë.  
Dhe bijtë e tu,  
bijtë luanë,  
si bishte-bishte u përndanë,  
secili për vetvete e donte namnë,  
me gjoks u matën,  
por, eh, sa shumë ranë,  
dhe u dërmuan e u vranë  
me ujq romanë e bizantinë,  
dhe s'gjetën  
shtigjet për lirinë,  
se s'gjetën  
shtigjet për bashkimnë!

Kjo ndodhi...  
E ç'ndodh vlen si mësim i historisë!  
Tashti po flas,  
me sytë ndaj përjetësisë,  
me zérin e së arthmes s'Ilirisë:

Nga dhëmbje shekujsh  
ndënë yje e diell,  
nga shpresa shekujsh  
ndënë yje e diell,  
kudo ne do kundrojmë,

14495  
38370

në nulla, kodra dhe kasolle,  
në çastet më të çartur për vend tonë,  
kur terri ngjan  
se po tret dritën,  
si do të shkrepë shpata jonë!  
Një agim i kuq i' ri  
do lindë  
mbi shkrep të Krujës kastriote.  
Nëndor  
do ndizet ajo dritë,  
që aqë tepër  
patëm pritë!»

### Kështjellë në mes të detit

«Në gjurmët  
pa m'u futur gjëmb, as ferrë,  
sa t'hapësh dhe të mbyllsh qepallat.  
që nga Bagdati,  
Shami e tatëpjetë.  
kryq-e-çkryq  
ndër kodra edhe kala Ballkanit,  
princër,  
pushtete,  
popuj,  
të gjithë i bëra petë!  
Bizanc —  
Fanari gati po venitet,  
Romë —  
Tiara në Shën Pjetër kolovitet,  
rrospia Venedik  
gjinjnxjerrë më vërtitet,

për 'të çdo gjë  
me pare blihet, shitet,  
sepse, si drita e diellit fare açik e dinë,  
që po mos dilnin djajtë  
arnaut-hainë  
edhe arslani Skënderbeg,  
unë, Sullatani,  
Shpata e Allahut,  
sot do t'isha  
mbi gjithë lëmsh të dheut,  
mbi fusha, male ,e kodrë, e breg  
i plotfuqishmi fshikull,  
shkop e zot!

Uh! O nëndor,  
mos u ndjefsh kurrë!  
Ç'ma ngrite kundër Skënderbegnë,  
fatosin  
që flakroi dhenë!

«O Padishah,  
rrufe e zjarrtë,  
t'u bëftë bota hi e baltë!  
Më ndjeni,  
po, a matet dot një Gjergj i gjorë  
dhe një grusht burra arbërorë,  
me ju, Sulltan,  
një katallan,  
q'errson dhe djellin me taborrë?  
A matet dot  
një krua i mjerë,  
qoftë dhe Kruja e Skënderbeut,  
me gjithë detet  
që ka lëmshi i dheut?  
Kështu mbllaçiti,  
duke fshirë halitë

me buzë e jargë,  
një bizantin i lig,  
një zabërhan,  
q'e mbante veten historian.

«As m'u shport sysh  
urum zuzar,  
gjidi këlysh kobar,  
zdërr zabërzanji!  
çfryu si ujk Murat sulltani!

Pastaj  
u ngrit  
dhe sytë mekamit ja vërvit...

### Zëri i Tokës

I vrerosur,  
handakosur,  
ujk në arrëz i plagosur,  
Padishahu, sygjakosur  
lëvir lutjet:  
«Mekam, derman!  
Mekam, aman!  
Fathënë e shenjtë,  
nga ç'djall millet  
do t'jenë shqipëtarët?  
«Kurbatë», jo,  
siç dërrvërrin zabërhanë  
e lajkatarë.

Derman, mekam!  
E gjeta pisk pise me 'ta!

S'më vete fare mbarë.  
Sa unë u sulem,  
atje dhe shtigje  
e prigje,  
pa pritur e pandehur,  
të ndrrohen në dragoj.  
Dhe pyje  
e vrrije  
mprehen në shigjeta.  
U vesha bidevi çelik,  
dhe vetë diell'e qiell errësova  
me ushta  
e gjyle topash e havanësh!  
Por nuk e di  
përse s'më mbrothi,  
s'më shkoi mbarë  
me djajtë e shkrepit.  
djajtë shqipëtarë!»

«Sultani, sultani,  
s'ma priste mëndja  
që t'ishe edhe i marrë!  
Nuk ka Allah,  
dhe as mekam!  
Andaj s'të gjenden krahë dot!  
Jam nëna-Tokë  
e mjaft po të duroj.

Në Arbëri,  
që kur buizi jetë,  
buizën dhe të parët  
e trimave shqiptarë,  
pa numur bij e bija,  
pë: pallë, ushtë e shpatë,  
për plug e parmendë,  
të gjithë flugëtarë zemërfakte!

Në shkëmb  
ndër arbër jeta u gdhënd!

Në shkëmb  
ç'u gdhënd  
s'jargoset dot me jargë!  
Vrej rretheqark:  
pëllëmbë e dhe  
është mbjellur koska e varre.  
Ku varre ka,  
atje ka edhe jetë,  
përlindie  
edhe blerim për jetë!  
Blerimnë e jetës  
s'mund vdekja  
krejt që ta kositë!  
Kërkon të dish,  
Sulltan Murat,  
përse s'të mbroth,  
nuk të shkon mbarë  
me bijt e shkrepit,  
shaipet shqipëtarë?  
Nuk të mjafton  
as veshia bidevi çelik,  
as ushta  
e gjyle topash e havanësh.  
që vetë diell'e qiell errësojnë!  
Të duhet dhe diçka  
që dot s'e ngjiz asnje evgjit —  
kovaç i yt.  
Të duhet dhe diçka  
që dot nuk mund të blihet.  
siç blihen Venedik  
me metelik,  
dhe krerë  
avo rreshperë,

që ti m'i bën bejlerë;  
të duhet edhe zemër  
me dej pejza çeliku!

Atë s'e ke!

As mund ta kesh!

Pra, me shqiptarët  
pendë e qe mos mbreh!

### Shigjeta zekth

Prej nënës Tokë,  
kokë kamzhik-rrahur,  
Sulltani,  
si mblodh veten pakë.  
kurrizin ktheu nga mekami.  
Me karthja e shkarpa ndez një flakë.  
gjunjë e gjymtyrë,  
e zemrën,  
hej kallkani,  
ai t'i shkrijë.  
Kaloi mjaft kohë,  
e tash me vete flet:

«Qen bizantini  
paska hakë!  
Nuk pikérka ujë n'Arbëri  
vetëm zjarr, e tmer, e flakë.  
havanë, topa  
e mizë lisi ushtri!  
U dashka mprehur edhe më  
shigjeta zekth,  
lavdashja lozonjare,  
pelini që varros bashkimnë.

siç bënë lashtit  
romakë e bizantinë!»

... U tretën vjet  
në gjuhët flakë,  
me dallgë-dallgë dangallakë.  
me helm e zi  
e pabesi ...  
Por as sulltani,  
as shejtani  
s'ta panë shqinën  
Shqipëri,  
se prijës  
oate Skënderbenë,  
draguan  
që drithmoi bedenë!

### Kor fusharak

Mbi brinja e brigje  
dhëmbë-gdhendur,  
mbi çdo fortin fortëse  
gylesh shëmbur.  
me syt nga Lezhja  
gjire-plagë,  
ndaj gurit.  
varrit të Skënderit.  
në ballë velin  
valë e vlagë:

flamurë e kuq  
me tonën shkabë,  
për vit,  
çdo fund kallnorit  
dhe nëndorit,  
një kor valkirjesh,  
vasha shqipëtarit  
i thurret pa rreshtur  
gurit,  
rrasës varrit:

«Ç'ësht kjo mjergull  
kaq e rëndë,  
që ka mjergulluar vëndë?  
Ky zëndan,  
kjo zagushi  
për të zezën Shqipëri?  
Gjergj,  
gjëmimi me rrufe.  
dil, o dif  
dhe u rrëfe  
kapedanve shqipëtarë,  
se të ndarë  
hapim varrë!  
Kryqit,  
Hënës,  
jepu nëmë!  
Ja ç'kérkon e zeza mëmë.  
Gjergj, fatos,  
çpalos flamurë!  
Na bashko!  
Pa gurë e drurë,  
prap do ndrrohen n'ushta e shpata  
gjithë armiqtë  
t'i zërë data!»

## Kushtrimi i Varrit

«Kush është trim! Kush është trim'  
Ja vdekje! Ja liri!»  
Nga varri vetë  
thrret Skënderi.  
E drrasa e gurtë e tij  
të ndrrohet në dori!  
Dhe shpata e tij  
vringllin vrastare,  
valvit si flamur prigjeve shqiptare!  
Buri buçet  
çdo trevë e det  
si çekan çetash shpërblimtare...  
Shqiptari flet:  
«Shqipja më s'pret,  
dhe flatrat rreh  
Prizren e Frashër,  
Deçiqaç, Vlorë:  
padit zinxhirët zgjyrëtorë:  
«Dhe dritë e diell  
ju na mohuat!  
Dhe dot nuk shijuam  
as pranverat,  
e verat;  
por dimret  
dhe skëterrati,  
në zift zëndani  
që gatuat  
me ujq çezarë  
e frota legionarë.  
Byzanc,  
e plot bylykë me barbarë.  
ordhi me jeniçerë  
e me asqerë!  
Sa bukur fort i njohëm,

dhe i njohim.  
Dhe plagët që na latë,  
ne i shohim.  
Por, hej! askurrë iu dot nuk e përf  
ç'armë të fshehtë e mrekulli,  
ç'armë-magji.  
ç'punishtesh flakë e shpatë.  
farkon në kudhrën-gii  
kjo tokë kaq e lashtë.  
ilirja Shqipëri!  
Shekuj e shekui  
vërtitet vrundull  
lëmshi i dheut!  
Por vallë askush iu s'ju rrëfeu.  
të vokën dë nga Burri  
e Skënderbeu,  
se pyrgjesh eshtrash  
dë u ngritën.  
si nishëtarë llamburitës.  
valviten flamui gjoks-zhuritës.  
mprehen hanxharë hasm-goditës  
dhe zjen kushtimi kryengritës?  
... Sérishmi  
dhe e det.  
ushtojnë varret stërgivshore.  
në hone, gryka e bregore:  
Nëndori i Kruiës  
po thërret.  
Nëndori i Vlorës po buçet:  
«Shaintari ngrë flamurë e vet.  
prap le të derdhet gjaku det!»

## KOHA E TRETE

### Furtuna jonë

I heshtur rri,  
si ne dhe ti,  
o deti ynë, deti batërdi!  
Ti na shastis  
dhe shtatin na drithton:  
Kush ty,  
o Det-rëmet,  
të fshehtat t'i zbulon?...  
Po ja! Po ja!  
Diçka nis e gjëmon,  
dhe vala turfullon:  
Në gji të detit tallazi,  
ngjizur prej helmi e gazi,  
po ngrihet,  
shtrihet,  
rritet  
me vriknë e vetëtimtë të rrufesë:  
mbi kreshta dallgësh qelli e plumbi.  
flamur po valvitet  
stërbindja,  
që bën pluhur  
ordhi, burgje, fortësë!

Dhe zemra zgjohet!  
Dhe rreh si vala e detit,  
se ndjemë,  
e pamë  
pushtetin e pakundshoq të oqeanit!  
Se ndjemë  
e njohëm  
gjithfuqinë e oqean-rëmetit!  
Dhe ne  
stërnipët e ilir viganit,  
u ndjemë  
thërmijzë e Rëmet-oqeanit!

Kjo ndodhi  
sa qfryu me fërtymë  
«Aurora»  
e vëlla Ivanit!  
Ahëre edhe ndër ne  
sërish,  
po ndryshe  
ja ndjenë shkabës tërbimnë:  
jo më nga majat,  
por nga mykat  
shigjeta jonë u mpreh:  
u ndjemë Ante,  
nga nëna Tokë  
ne muarrëm fuqinë,  
Dhe nisëm sulmin  
mbi shtërgata e re  
rrebesheve zëndanit:  
Tallazi i kuq  
dhe ne  
na e dha të kuq kushtrimnë!  
Se e pa dhe qiel e dhë:  
në vetëm dhjetë dit  
krejt lëmshin planetar

me metropole  
skllev e monopole,  
të gjithë i tronditi  
furtuna e Oqeanit proletar!  
Ne dritën syve na vërviti,  
Gjeniu i tij,  
edhe na shkundi kur buçiti:  
«Romaku i ri  
me sërb-grek-bizantinë,  
siç desh shtrig-kapitali,  
për Shqiprinë  
e prenë, e qepën  
qefinë,  
si mos ish vend e popull,  
po kërmë-stërvinë!  
Hap sytë shpejt,  
qyqar i shkretë, o shqipëtar,  
o punëtor, bari edhe fshatar!»  
Shpejt djemtë e shqipes,  
kudo,  
ngado  
lëshuan thirrjen tramundanë:  
«Shkëmbinjtë-ortekë  
të jenë topa e xhebehanë!  
Hanxharët-shpata!  
Dhe zjarr-armët me gjalmë!»

E ngrihet vendi anëmbanë!  
Mbi varret stërgjyshore  
nga Veleçik e Çikë,  
besniken besë  
burrërisht e dhamë:  
«Si det nga ne vërdar të derdhet gjaku!»  
Edhe si det nga ne vardar nis derdhet  
gjaku.

Dhe Vendi-shkabë

qefinin  
në det me valë  
larg Vlorës  
me përbuzje e flaku:  
rilind liria  
n'agullim si gjaku!

Por, eh, zarbot, zabitët,  
këlyshët e Oxhakut,  
me bylmez-horra  
e qorra  
të bejlurçinës edhe t'Halif-bajrakut,  
në llum e batak zhgryer,  
në lëfyt lakun dhjamë-lyer,  
keq sérish na vunë!  
Dhe ne sérish  
kushtrimnë e dhamë furtunë:  
«O burra, o bij të vegjëlisë,  
në sulm mbi kobnë e tradhëtisë!  
Ta mbysim sérish  
gjak ne Vjosë e Bunë!»  
Gjëmoi Vlora e Shpella e Dragobise...

### Shkaba e Vegjëlisë

Tomorri, mali luan,  
i shënjtë e aqë i lashtë,  
m'i lashtë se krejt lashtëria,  
tund kreshtën,  
krelë me kurorë purpri,  
ngre grushtin lart  
edhe thërrret:

«Kostarë kobi,  
e korbat e tradhtisë,  
o shqipëtarë,  
o bijtë e vegjëlisë,  
o punëtorë, barinj edhe fshatarë,  
mbi Shqipëri u derdhën  
më me tërbim  
se kurrë asnje herë!  
Por kësaj herë,  
pas dimrit t'egër  
do vijë një pranverë,  
që ju s'e kini parë asnje herë!  
Andaj gëzoni!  
Kudo,  
ngado  
me gurë e drurë tok, galdoni,  
në fusha, e brigje, e anadetesh,  
se të pavdekëshmit u ngritën!  
Dhe këtë herë  
nga zemra e tyre  
kanë nxjerrë,  
në qìell të trevës sonë arbane,  
një Shkabë,  
me një yll në ballë.  
Dhe sytë e saj  
ndrisin si dielli!  
Me 'të pishtare  
anija jonë,  
edhe rrebeshet më mizore,  
tok me çdo vorbull tradhëtore,  
i thyen!  
Endrrat shekullore  
t'i kthen në flamuj,  
në fitore!  
Kjo është

Shkaba e vegjëlisë,  
Partia:  
Prijsja e Shqipërisë!  
Përpara, o bijtë e vegjëlisë!»

Dhe këtë thirrje të Tomorrit  
shqiptarët trima  
e dëgjuan.

... E gryka, hone,  
e male, e brigje,  
fshatra, qytete  
e anadete,  
e pranga e burgje  
ushëtuan  
nga krisma  
e pushkës partizane  
nga krisma  
e pushkës çlirimtare!...

Në katër vjet  
litarë e zjarre,  
me babëzitje, e krimë, e varre,  
nga flaka e luftës shpëtimtare.  
në katër vjet  
stuhi e dërmë,  
ulkonja Romë  
gërdallë u shkri.  
Dhe në gërmadha u poq,  
u dogj,  
ndotur si kërmë!...

Një tjetër derdhet përbimi ne:  
Ulkonjë e murme hitleriane!  
Më me tërbim  
tret gurë e dhe!

Buzë «herren-volk»,  
sy-dangë «ariane»,  
desh piramida që të ngrinte  
mbi varre mumjesh evropjane!  
Por Stalingradi  
dhe Arbri u ngre:  
prap me tërbim  
çdo harcë u mpreh!  
E krahë  
iu bë partizanit,  
edhe Tomorri me rrufe!

### Marshim çlirimtarësh

Mëngjez i purpurt.  
Nga malet tonë,  
që dborë ende mbanin,  
Brigada e Grupe zbresin  
në pllaja,  
e fshatra,  
edhe qytete e fusha.  
U dehen  
djemve t'yjve  
shkotat, gjoksi e gusha.  
E vлага e dheut  
për plug i fton n'ugare!  
Por s'ndalen trimat.  
Dhe hapi i tyre rritet:  
dishka e madhe,  
diku në ato dit po pritet!

Si ushta ata  
çajnë erën ndaj Përmetit,  
ku zbardhin  
edhe muret shkrumb<sup>q</sup>  
te Vjosa rrjedhë-turbull,  
valë-vrumbull,  
tok me shtëpitë e kopshtet,  
e udhë, e udhza të qytetit  
bukë-pakut e ujë-detit».  
Këndojnë,  
vallzojnë  
çlirimtarë e popull  
gjithë grumbull  
dhe çlirimtaret tonë,  
vashat me yje, faqekumbull.

O partizanka,  
flok-shkurtra me gërshteta,  
të pastra si burbuqet pranverake,  
s'u endët ju ndër lulet  
posi bleta!  
Por shpejt sërish,  
o motra,  
o bija skamjeje e flake,  
ku urdhër dha reparti,  
foleja juaj,  
zemra edhejeta,  
«Gati!» vrapthi u gjegjtë.  
Dhe në rresht,  
ushtarake,  
për front u nisët,  
në front për Rëmetin,  
në front si barikadë për Përmetin!

## Dhuratë vashash

Dhe ndënë shkrumb e hi  
vjollcat po gufmonin,  
e lart, nga ajri  
langojtë e murmë përgjonin:  
me hundë e veshët ngrehur  
të zbulonin  
në ç'vend  
e kënd  
të «kuqtë çlirimtarë»  
do bënin mbledhje.  
Me ankth kërkonin  
dhe ditën e sahatin .  
Pastaj,  
e dinin vetë  
çdo punonin:  
nga toka e qelli  
si llavë do vërshonin,  
me zjarr e flakë,  
e shkrumb e hi,  
edhe kërdi  
e batërdi,  
do shuanin në gjak inatin.

Por, hej!  
Dhe gurët e shikuan,  
e bishët e dëgjuan,  
se qysh inatnë  
langojtë e murmë e shuan:  
si robër vashash  
ata parakaluan!  
Po, robër  
ranë fricët e Prusisë,  
se pisk

e brisk  
e panë te Ura e Peratit,  
kur skuqej Vjosa vetë  
shtratit e shpatit,  
dhe keq kosiste  
drapri çlirimtar i Arbërisë:  
Dhe gjithë thirrën:  
«Gjallë e me turp,  
më mirë se plumb shtatit!»  
Edhe me bisht në shalë,  
e turinj-vrarë,  
brigjeve Shqerisë,  
këlyshët e ulkonjës së Prusisë,  
nën urdhër partizankash  
Përmjet zbresin:  
«Dhuratë vashash çlirimtare  
për kongresin!»

### Buzëqeshje qiellore

Vorrezë u bë  
çdo gropë e çdo greminë  
për horrat «herren-volk-as» të Hitlerit!  
Për ne, bijtë e ilirve,  
pëllëmbë e gur,  
e rrugë e barikadë —  
shtatore, e shëmbëlltyrë e nderit!

Çfarë shpërthim  
Shqiprisë n'ato ditë:  
në fusha e fshatra,  
bregdet dhe bregore,

kodrash, kopshtijesh dhe korijesh,  
në rrugë e njerëz,  
në det e dritore,  
dhe lart në hapësirat kaltërore,  
çdo gjë, çdo gjë —  
në nisje nusërore!

Dhe mëma Shqipëri,  
në fund, i fshiu sytë:  
«Arrita, tha, në majat më gazmore!»  
Nëndori i Krujës thërriti,  
Nëndori i Vlorës buçiti,  
Nëndori i Tiranës ja priti:  
«Mbi bunker, bedenë graniti,  
liria buzqeshi diellore:  
Shqiptari flamurin përjetë e ngriti! —

## KOHA E KATËRTË

### Mëngjez shqipëtar

Po zbehen qiellet qetë  
njëri pas tjetrit yjtë.  
Dhe sytë  
pulit dasmor djalosh agimi.  
E napa e trandafiltë  
çdo kind të saj eterit valavit.  
Me qik e mjergull,  
si bryma  
të errëtit po shkrin.  
Nga lindja  
shkëndijëzat  
i kuqi diell kalorësishët lëshoi  
dhe skuta e thellë  
hone sh, hauzesh e grykave po ndrin.  
I krehën krelat kreshtash  
Tomorri, mali luan,  
i shënjtë e aqë i lashtë,  
m'i lashtë se krejt lashtëria,  
Korabi,  
e varg pas vargu, Alpet shqipëtarë.  
Dhe çuka e Çikës  
me Veleçik  
vëzhgojnë me sytë prej fajkoi.

Qytete, fshatra,  
e fusha, e detet tonë,  
Adria tok me Jonë.  
u gdhinë vaj të qetë,  
me gushën prej pëllumbi e ergjëndare..

### Zëri i kohës

Tremijë vjet,  
sa mban mënd njerëzia,  
mbi treqind herë  
në fushat shqipëtare  
vërdoi vërdallë  
flaka e shkrumbi,  
litari e plumbi,  
e këmba e barbarit...  
Por dhe në flakë e shkrumb  
e në litar e plumb,  
kjo Shkaba e shqiptarit,  
kushtrimin dha  
e si shigjetë shkrepi.

Jo kot lashtëria  
legjenda na pat thurë  
rreth një shpendi  
q'e quajtën Feniks,  
që shkrumb ta bësh  
e hi,  
ai prapë të rilind,  
ashtu siç ish,

medje, edhe m'i fortë e m'i ri,  
nga shkrumbi  
e hiri i tij.  
Shëmbllën e mori  
nga Shqipja jonë ilire  
e lirë,  
nga Shqipja-Shqipëri.  
Kur ti armik,  
asfare nuk e pret,  
të ngrihet befas  
edhe me zënë e saj tinguj çelik  
më me rrebesch e tmer buçet,  
sa dridhet tokë,  
e qiell, e det:  
«Jam Shqipja ilire  
e lirë,  
dhe balta e varrit nuk më tret;  
jam dritë dielli  
e dashuri,  
për lule bijsh të lirë,  
për liri!»

### Një det trandafilash

Më njomen sytë prej mallngjimit:  
një det  
trandafilash agimit,  
shoh mbi flokë  
të mëmës, t'arbëreshes tokë.  
Fytyra të bronxta,  
të nxira

nga barot,  
edhe tym e tufanë;  
dhe sy depërtonjës  
që shkrepin si yie,  
o shokë, o sy partizanë,  
që shkritë  
fortina e zinxhira,  
ju shoh,  
me puntorë e fshatarë,  
tek plagët e luftës  
me rrypa këmishësh fashoni,  
se jetën e blerët,  
kudo përqafoni! . .

O varre,  
o varret tonë,  
o varret me dëshmorë,  
o jetë e përjetshme,  
e thurur gonxhe lulesh e kurorë,  
o shokë e shoqe,  
o ju dhëndurë e nuse të përjetshme  
të lirisë,  
o vjollca të pavdekshme të Shqiprisë,  
përpara jush japim betimin:  
«Përpara do çajë Atdheu!  
Dhe lule do çelë pranvera  
në tokën e ngrohtë arbrore.  
Se ne gjithmonë,  
me hov, më me hov,  
e përhëra,  
do çajmë përpjetë si era,  
me ritme e sulm të mahnitshëm!

O pirgje shekujsh me dëshmorë.  
dhe ju të rinj,

me yllë e kuq në ballë,  
o partizanë,  
o partizanka,  
o vashat,  
flokëshkurtëra e me gërsheta,  
të pastra  
si burbuqet pranverake,  
që nuk u endët lulesh  
posi bleta,  
dhe si burbuqe  
u mbet pa çelur jeta,  
se ratë në përpjekjet luftarake, —  
o ju të gjithë,  
të lashtë e të rinj,  
o ju të vdekshmit e pavdekshëm.  
o më të gjallë se të gjallët,  
përherë ju me ne jetoni,  
ndër ne përherë ju lëshoni  
aromë dashurie të vërtetë!

### Mirënjojje

Shqipria mëmë u gdhi  
si nuse e nisur,  
e stolisur.  
E krejtja e madhe  
e gjen pérherë  
e më të freskët:  
parfum shpërthen  
çdo kopshtë ndaj agimit;  
furmaltat shkrijnë  
dhe në çelik i kthejnë

dhe shkrepat më rebelë.  
Në humnerën vetë,  
ku është m'e egër e m'e thellë,  
dhe dimrin më të egër  
e kthejmë në pranverë!  
Dhe nga çdo skaj e skelë e piramidë,  
nga portokalli gjer lart në borigë,  
me male e fusha  
e zaje shtretesh,  
ranishte e brigje,  
e dete e dallgë buzë e dhëmbë-bardhë,  
e kodra e pyje,  
të shtrenjtët dhe të shenjtët pyje  
të stërgjyshve tanë,  
burim i jetës tejemanë;  
dhe hone, hauze,  
prozhme, pllaja, e bredha,  
e bjeshkë e shkita.  
dhe inxhi kantieresh,  
fshattrash, qytetesh,  
në tinguj bolshevikë të drapër-çekanit,  
të gjithë,  
sapo zgjohet dita,  
mirnjohje zemrash të dërgojnë,  
ty, o Parti,  
o zjarr i Diellit tonë,  
prej popullit, —  
brigadë sulmi e Rëmet-oqeanit!

Andaj me gaz e vrull të mungullimit.  
më me rrëmbim përdita  
të rreptat rrjedha lumenjsh,  
ujvarash rrëkellehen!  
Edhe më rreptë  
i rrabin krahë e llërë trimash,

në volt t'i ndrojnë,  
në ushta shkëndijë vetëtimash;  
n'ushta t'i ndrojnë,  
ashtu si ne, njerzit, dëshirojmë:  
në diga,  
për gufim të gjelbërimit;  
në verë e mblatë  
që të ngjatjetojmë  
Mirushen tonë, nënën Tokë  
dhe Diellin e dashur t'amshimit!

Kudo,  
ngado,  
si sot e mot,  
e pér nga mot,  
me hov të hareshëm betimit,  
edhe në pragun e dimrit,  
të gjithë i këndoymë blerimit,  
blerimit tonë jetë e zjarr,  
Nëndorit tonë çlirimtar.

## SHËNIME

1) Aluzionet legjendare dhe historike në këtë poemë pësh-teten në të dhëna historianësh të ndryshëm, të vjetër dhe të kohëve tonë. Lexonjësi që është marrë me historinë tonë, pak-a-shumë është në korrent të tyre.

2) Këtu do të japim ndonjë sqarim, që mendojmë se është i nevojëshëm:

a) Legjenda e Bardhës me Yllin është një përpunim poetik i autorit, i pështetur, me ndryshime, te Appiani dhe te besimi i vjetër i popullit tonë në Orët. Siç dihet *Ora e bardhë* është Ora e mirë për njeriun. Vetë fjala «Galatea», në shqip i afrohet «Orës Bardhë».

b) Fjala *Bardh*, fjälë e vjetër ilire, në latinisht jepe me *Alb*, (Këndej edhe fjala *Alpe*-t = *të bardhët*. (malet me borë). Këtu autori mori guximin të hedhë hipotezën se mos fjala *Albanë* është një latinizim i fjalës ilire *Bardhanë* (Arda-nët janë qojtur edhe *Vardanë*, ose *Bardanë*, pra, edhe *Bardhanë*). Një mendim të tillë e ka çfaqur edhe dijetari arbëresh Kamarda, po jo për Ardanët, por për Parthinët. Që Ardanët, (Vardanët, Bardhanët) kanë qenë fisi ilir që ka lojtur rolin më të madh në historinë e atyre kohëve, kjo dihet. Andaj llogjikisht mundësitet janë më të mëdha që edhe ndër të huajtë ky fis të ketë ngjallur interes më tepër sesa të tjerët. Pra, edhe mund që emri i tyre të jetë latini-zuar prej romakëve, ashtu siç u greqizua p.sh. emri i fisisit *Taulant* (që sipas dijetarëve vjen prej fjalës ilire «*dalla-ndyshe*») me korrespondentin e tij grek «*Helidhon*».

3) Kuptimi i disa fjalëve pak-a-shumë të rralla në kon-tekstin e poemës: 1) *amvonë-a* = këtu: kuvend, këshillë; 2) *amzën* = këtu: shijen; 3) *bylmez-horra* = këtu: vagabon-dë, injorantë; 4) *bidevi* = turq. krejt; 5) *vëlla-Ivanit* = po-pullit rus; 6) «*herren-volk*» = gjerm. «popull-zot» (populli gjerman sipas nazistëve); 7) *flugëtar* = energjikë; 8) *urum* = këtu: grek, bizantin; 9) *vërdoi* = zhvilloi aktivitet të madh; 10) *zërë-a* = zanë-a (përdoret më Labëri).

БАЛЛАР

### ДИЧ И АНОИ

01 ..... вишиштати кашкай  
02 ..... вишиштати кашкай  
03 ..... вишиштати кашкай  
04 ..... вишиштати кашкай  
05 ..... вишиштати кашкай

### ИТУО И АНОИ

01 ..... вишиштати кашкай  
02 ..... вишиштати кашкай  
03 ..... вишиштати кашкай  
04 ..... вишиштати кашкай  
05 ..... вишиштати кашкай  
06 ..... вишиштати кашкай

### ДИЧИТ И АНОИ

01 ..... вишиштати кашкай  
02 ..... вишиштати кашкай  
03 ..... вишиштати кашкай  
04 ..... вишиштати кашкай  
05 ..... вишиштати кашкай

### ИТИСТАЛ И АНОИ

01 ..... вишиштати кашкай  
02 ..... вишиштати кашкай  
03 ..... вишиштати кашкай  
04 ..... вишиштати кашкай  
05 ..... вишиштати кашкай

38370

ZGJEDHJE KOMUNALE  
VOTE HASSER

## TRYEZA E LËNDËS

Faqe

Prelud .....	3
<b>KOHA E PARE</b>	
Jehona legjendash .....	6
Tabllo ilire .....	9
Shtërgatë .....	10
Përbimitje .....	11
Divi ilir .....	12
<b>KOHA E DYTE</b>	
Në prag të Nëndorit të Krujës .....	16
Këshijellë në mes të detit .....	18
Zëri i Tokës .....	20
Shigjeta zekth .....	23
Kor fusharak .....	24
Kushtrimi i Varrit .....	26
<b>KOHA E TRETE</b>	
Furtuna jonë .....	28
Shkaba e Vegjelisë .....	31
Marshim çlirimtarësh .....	34
Dhuratë vashash .....	36
Buzëqeshje qjellore .....	37
<b>KOHA E KATËRTE</b>	
Mëngjez shqipëtar .....	39
Zëri i Kohës .....	40
Një det trandafilash .....	41
Mirënjojhe .....	43
Shënimë .....	46